



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1749 Prot.

Tiranë, më 18. 12. 2018

V E N D I M

Nr. 252, Datë 18. 12. 2018

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 84, datë 08.06.2018, e një grupi personash¹ të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, kundër Drejtorisë së Rajonale të Shëndetit Publik Korçë dhe Bashkisë Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të *“racës, ngjyrës, gjendjes ekonomike, gjendjes arsimore, gjendjes shoqërore dhe gjendjes shëndetësore”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesit kanë parashtruar se janë një grup banorësh të cilët i përkasin komunitetit rom/egjiptian, që jetojnë në godinën e ish- konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë. Më parë kanë jetuar në zonën e ish-Poligonit. Për arsye të ndërtimeve urbanistike nga ana e Bashkisë Korçë, janë larguar prej aty dhe janë strehuar në ish-konviktin e Shkollës Bujqësore. Në këto ambiente, të

¹ K. G., K. M., M. G. dhe E. Ll.

përshtatura nga ana e Bashkisë Korçë, banojnë rreth 35 familje dhe afërsisht 130 banorë. Secila nga familjet e strehuara shfrytëzon nga një dhomë konvikti për të jetuar, si dhe një tualet të përbashkët për 5 familje. Aktualisht kushtet higjieno-sanitare janë tepër të rënduara, sa mund të përhapet epidemi. Një grup banorësh dhe fëmijët e tyre janë shtruar në Spitalin Rajonal Korçë, për shkak të lagështirës, mykut dhe ambjenteve të papërshtatshme të godinës.

Në përfundim, ankuesit kërkojnë që, të zhvendosen nga ambjentet e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore dhe të strehohen në një ambjent të përshtatshëm, si dhe të merren masa të menjëhershme për dezinfektimin e ambjenteve të konviktit, në mënyrë që të mos përhapen sëmundje epidemike.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmoi hapat procedural si më poshtë vijojnë :

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

1. Mbështetur në Urdhërin nr. 114, datë 08.06.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetit Publik Korçë, Bashkisë Korçë dhe Spitalit Rajonal Korçë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e banorëve të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë”, më datë 11.06.2018, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë institucioneve të sipërcituara, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Fillimisht inspektorët³ dhe specialistja⁴ e KMD-së, morën takim me banorët e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë dhe u informuan rreth situatës dhe ankesës së tyre. Gjatë kqyrjes së ambjenteve të banimit dhe të godinës në tërësi, në të dy katet e ndërtesës, u konstatua se në dhomat ku ishin strehuar ankuesit, kishte një prezencë të lagështirës dhe mykut. Në disa prej ambjenteve të banimit, evidentohet një mbipopullim, pasi në disa prej dhomave jetonin dy ose tre familje, me një përbërje prej 6-7 persona. Pjesa më e madhe e tualeteve dhe lavamanëve në to, ishin të bllokuara dhe jashtë funksionit. Gjithashtu, dyert e tualeteve ishin të thyera dhe pa xhama.

Kati nën tokë i godinës (bodrumi), ishte i mbushur me ujëra të zeza që vinin nga katet e mësipërme të ndërtesës, si dhe mbeturina të ndryshme. Në të gjithë ndërtesën konstatohet një erë e rëndë për shkak të grumbullimit të ujërave të zeza në katin nën tokë. Në përfundim të inspektimit dhe takimit me banorët e ish-Konviktit, u realizuan rreth 80 foto, të ambjenteve të godinës.

- Më pas, Inspektorët u paraqitën pranë Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, ku morën takim me drejtuesin e Institucionit, M. Ll., me N. M., i cili mbante detyrën e Shefit të Shëndetit Mjedisor Korçë dhe M. K., me detyrë mjeke Epidemiologje, pranë DRSH Korçë.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, sqaruan se pasi janë vënë në dijeni nga përfaqësuesja e KMD-së në Korçë, E. T., kanë ngritur një grup inspektimi, i cili është paraqitur dy herë pranë ambjenteve të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë. Gjatë inspektimit ishte konstatuar se gjendja e këtyre ambjenteve të banimit ishte jashtë kushteve higjeno-sanitare. Kishte një prezencë të madhe të lagështirës dhe dëmtime të suvasë. Tualetet ishin të pamjaftueshme për numrin e personave që strehuar në atë godinë. Deri në ato momente nuk kishte prezencë të ndonjë epidemie, por nëse nuk merreshin masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Korçë, gjendja mund të agravohet deri në shpërthimin e ndonjë epidemie. Në këto kushte dhe mbështetur në situatën e konstatuar, në rrugë informale (me telefon), Drejtoria

³ A. Xh. dhe R. B.

⁴ E. T.

Rajonale e Shëndetësisë Korçë ka njoftuar Bashkinë Korçë dhe i ka kërkuar të ndërmerren masa për përmirësimin e kësaj situatë.

Në përfundim të inspektimit, Drejtoria Rajonale Shëndetësore Korçë, me anë të shkresës Nr. 279 prot., datë 11.06.2018, vuri në dijeni Bashkinë Korçë dhe kërkoi të merren masa të menjëhershme për ndërhyrjen dhe evitim të problemeve shëndetësore të këtyre banorëve.

- Në vijim, Inspektorët u paraqitën pranë Bashkisë Korçë, ku morën takim me Zv. Kryetaren, B. Th.

Gjatë takimit të zhvilluar, B. Th., sqaroi se ishte ngritur një grup pune nga ana e Bashkisë Korçë dhe së shpejti do të niste nga puna për ndërhyrjen dhe marrjen e masave për të zgjidhur problematikën higjieno-sanitare të godinës së ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë. Gjithashtu, B. Th. informoi se, nëpërmjet bashkëpunimit me OJF, pranë ndërtesës së Ish-Konviktit, do të hapet një mence për këta banorë, ku do t'i ofrohet ushqim falas, për një numër 200-250 persona. Në përfundim, B. Th., theksoi se do të vërë në dispozicion të KMD-së, informacionin për çdo hap që do të ndërmerret nga Bashkia Korçë, për çështjen në fjalë.

- Në përfundim të hetimit, Inspektorët u paraqitën pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Korçë.

Gjatë takimit të zhvilluar në Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor Korçë, Inspektorët e KMD-së, morën takim me A. H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Inspektimeve. Pasi u informua mbi situatën në të cilën ndodheshin banorët e ish-Konviktit të Bujqësorës dhe gjendjen higjieno-sanitare të godinës, A. H. sqaroi se brenda datës 13.06.2018, nga ISHSH, do të caktohet një grup inspektimi, për të bërë evidentimin e situatës dhe më pas ti referohet situata Bashkisë Korçë, si organi kompetent për të marrë masa për zgjidhjen e kësaj situatë. Në përfundim, A. H. sqaroi se, do të vërë në dispozicion informacionin mbi hapat e ndërmarra nga ana e ISHSH Korçë.

Përsa më lart, ISHSH Korçë, me anë të shkresës Nr. 436/1 prot., datë 18.06.2018, vuri në dijeni Komisionerin se nga ana e këtij institucioni janë marrë masat për ngritjen e një grupi kontrolli dhe inspektimi për situatën në të cilën ndodhen banorët e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë. Grupi i punës, pas inspektimit të kryer në mjediset e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore, ka konstatuar se këto ambiente nuk plotësojnë kushtet minimale higjieno-sanitare për të qënë ambiente banimi. Gjithashtu, është konstatuar:

- Keqfunksionim i rrjetit të kanalizimeve për largimin e ujërave të përdorura; Ujërat sipërfaqësore kanë shkaktuar bllokimin e kanalizimeve në pikat më të ulëta të tyre (rrjeti ekzistues është nën nivelin e kolektorit) dhe për pasojë në mjediset e nëndhëshme (bodrumet) është prezent dhe prania e ujërave të përdorura. Lagështia kishte depërtuar

deri në muret e katit të parë dhe aroma e pranishme e mykut ndjehej që në hyrje të objektit. Bllokimi i tubacioneve ka sjellë dhe mosfunksionimin e nyjeve sanitare të katit të parë.

- Nyjet hidrosanitare të dëmtuara dhe disa të tjera janë vëtzënë nga disa banorë dhe si pasojë numri i tyre nuk është i mjaftueshëm në raport me individët që banojnë në këtë objekt.
- Rrjeti elektrik është i dëmtuar dhe ka përcjellësa jashtë kushteve të sigurisë teknike, duke vënë në rrezik dhe jetën e banorëve.
- Në katin e dytë konstatohet prani e lagështisë në mure dhe tavanet e disa dhomave si pasojë e dëmtimit të ullukëve

Nëpërmjet kësaj shkrese, ISHSH Korçë, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Korçë, ndërhyrjen urgjente në këtë objekt për:

- Rregullimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të përdorura (eliminimi i bllokimit të shpeshtë të tij, duke ndërhyrë në rrjet pasi ai ekzistues është nën nivelin e kolektorit);
 - Sistemimi i rrjetit elektrik sipas kushteve teknike (sistemimi i kabllave të varura);
 - Rregullimi i ullukëve të dëmtuar dhe i tubave të ujërave sipërfaqësorë;
 - Rregullimi i dëmtimeve në nyjet hidro-sanitare dhe lirimi i atyre të transformuara në magazina apo të uzurpuara nga disa familje.
- Për të evidentuar situatën shëndetësore të banorëve të ish-Konviktit të Bujqësorës Korçë, grupi i inspektimit të KMD-së, u paraqit pranë Spitalit Rajonal Korçë, ku mori takim me G. N., me detyrë Kryeinfermier.

Fillimisht, u kontrollua Rregjistri i Konsultës Terciare/Poliklinike të Pediatrisë, për të konstatuar fëmijët që janë paraqitur pranë Spitalit Rajonal Korçë. Sipas informacionit të administruar, u konstatua që për periudhën 1 Prill 2018 deri më datë 11.06.2018, janë paraqitur 7 (shtatë) fëmijë të këtij komuniteti, nga të cilët 2 (dy) prej tyre janë paraqitur me probleme infeksioni në lëkurë dhe fëmijët e tjerë janë paraqitur me shqetësime të grykëve.

Në vijim, u kontrollua Rregjistri i Shërbimit të Urgjencës së Pediatrisë, për periudhën 01.04.2018-11.06.2018, ku u konstatua se janë vetëm dy fëmijë të këtij komuniteti të cilët janë paraqitur me diagnozën Vomitus (të vjella), grykë të ftohura dhe diarre.

Në përfundim, u kontrollua Rregjistri i Shërbimit të Urgjencës, nga data 01.04.2018-11.06.2018 dhe nuk u konstatua të jetë paraqitur ndonjë nga banorët e ish-Konviktit të Bujqësorës me probleme në lëkurë apo diagnoza që vijnë nga kushtet e ndërtesës në të cilën jetojnë.

2. KMD nëpërmjet e-mailit, datë 22.06.2018, i kërkoi Bashkisë Korçë informacion dhe prova shtesë lidhur me masat e ndërmarra për zgjidhjen e situatës në të cilën ndodhen banorët e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Në përgjigje të e-mailit të sipërcituar Bashkia Korçë nëpërmjet e-mailit datë 29.08.2018, sqaroi se: *“Ju falenderojmë për adresimin e problematikës, e cila nga ana jonë është evidentuar dhe trajtuar në mënyrë periodike. Sikundër ju duhet ta dini, 40 familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian janë strehuar nga Bashkia Korçë në ambjentet e ish- konviktit të Shkollës Bujqësore për shkak të ndërhyrjes për projektin e Rivitalizimit të Pazarit të Vjetër të Korçës. Gjendja e ndërtesave tek Pazarit i Vjetër i Korçës ku edhe jetonin këto familje, ka qenë problematike, godinat ishin tejet të amortizuara, në disa prej tyre ka pasur edhe shembje. Pozicionimi i familjeve në këtë ndërtesë ka qenë një zgjidhje provizore e gjetur nga ana jonë, duke mbajtur parasysh faktin se kjo ndërtesë ishte në kushte shumë të mira dhe përmbushte standartet për të jetuar këto familje. Pasi këto familje janë vendosur brenda ambjenteve të ndërtesës, ne kemi marrë dijeni për problematika të lindura herë pas herë. Fillimisht ka pasur bllokim të tubacioneve dhe ne kemi kryer një ndërhyrje për rikthimin e tyre në funksion ndërsa konstatuam se bllokimi kishte ardhur si pasojë e hedhjes së mbetjeve dhe materialeve të ndryshme. Përveç mbledhjes rutinë të mbetjeve nga firma e pastrimit të qytetit, kemi ndërhyrë për pastrim të ndërtesës dhe amjentit rrethues, referuar një grafiku të përcaktuar, por edhe përgjatë aksioneve të pastrimit të qytetit kjo zonë nuk është lënë asnjëherë jashtë vëmendjes. Gjithashtu kemi bërë ndërhyrje të herëpashershme për heqjen e ujit nga bodrumet e ndërtesës, si dhe kemi ndërhyrë për dezinfektimin e saj. Përpos kësaj situatë ne jemi duke marrë masa për t'i dhënë zgjidhje përfundimtare problemit të higjienizimit të ndërtesës.”*

3. Duke qenë se informacioni i dhënë nga Bashkia Korçë, nuk sqaronte në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, atëherë për shqyrtimin e mëtejshëm të saj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Për këtë me anë të shkresës Nr. 824/4 prot., datë 04.09.2018, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 10.09.2018, ora 12^{0 0} .

Pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Korçë është marrë dijeni⁵ mbi shkresën Nr. 824/4 prot., datë 04.09.2018, të KMD-së, në seancën dëgjimore të realizuar më datë 10.09.2018, mori pjesë vetëm përfaqësuesja e palës ankuese, E. T. Në vijim të seancës nga pala ankuese u sqarua se: *“Aktualisht është realizuar pastrimi provizor i godinës së ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, si dhe rrethimi me murë, i cili ndan territorin e shkollës, nga ish-Konvikti, ku janë vendosur banorët. Nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të Bashkisë Korçë, është thënë që do të realizohen ndërhyrje në zëvendësimin e tubacioneve të dëmtuara në tualetet e godinës,*

⁵ Mbështetur në Lajmërim Marrjen e Postës Shqiptare, Bashkia Korçë është vënë në dijeni mbi shkresën Nr. 824/4 prot., datë 04.09.2018, më datë 06.09.2018

higjenizimin e ambjentëve, si dhe riparimin e suvave të cilat janë dëmtuar nga lagështira, por nuk është ndërmarrë asnjë hap për të riparuar dëmet e konstatuara në këtë godinë.”

4. Më datë 08.11.2018, nga informacioni i dhënë nga ana e përfaqësueses⁶ së banorëve të ish-konviktit të shkollës Bujqësore Korçë, KMD është vënë në dijeni se në datën 07.11.2018, është ndërprerë uji i pijshëm për të gjithë godinën.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Në mbështetje të provave të grumbulluara, rezultoi se në muajin Tetor 2016, pas rikonstruksionit të godinës së ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, familjet e subjekteve ankues janë vendosur në këtë godinë për një periudhë të përkohshme. Bashkia Korçë gjatë vitit 2017, pasi ka hartuar projektin, zgjedhur truallin dhe lejen e ndërtimit, ka aplikuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban për ndërtimin e një blloku banesash për komunitetin rom/egjiptian të qytetit të Korçës. Sipas informacionit të administruar, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Korçë, për periudhën 2017-2018-2019, ka përcaktuar prioritetet e investimeve, ku evidentohet se një prej tyre është ndërtimi i banesave për komunitetin rom dhe egjiptian.

Pavarësisht mundësive që u janë krijuar familjeve të vendosura në godinën e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore, referuar informacionit të administruar, kushtet e banimit të ndërtesës dhe hapsirat nuk janë të mjaftueshme për numrin e familjeve të vendosura në të. Në këto ambjente, të përshtatura nga ana e Bashkisë Korçë, banojnë rreth 35 familje dhe afërsisht 130 banorë. Secila nga familjet e strehuara shfrytëzon nga një dhomë konvikti për të jetuar, si dhe një tualet të përbashkët për 5 familje. Referuar inspektimeve të kryera dhe konstatimeve të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, godina e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, nuk plotëson kushtet minimale higjeno-sanitare për të qënë ambjente banimi. Në këto kushte, nëse nuk merreshin masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Korçë, për higjenizimin e godinës dhe riparimin e dëmeve të saj, gjendja mund të agravohet deri në shpërthimin e ndonjë epidemie tek banorët.

⁶ E. T.

Nga informacioni i administruar, nga ana e Bashkisë Korçë, pas ankesës së bërë tek KMD dhe kërkesave të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, janë marrë masat për pastrimin dhe largimin e ujërave të ndotura nga kati i nëndheshëm (bodrum) i godinës, por nuk është ndërmarrë asnjë hap për të ndërhyrë në 2 (dy) katet e sipërme të ndërtesës për të eliminuar lagështirën që gjendet në ndërtesë. Në këto kushte edhe pas ndërhyrjeve në katin e nëndheshëm, nuk është bërë higjenizimi i ndërtesës.

Sipas informacionit të dhënë nga pala ankuese dhe Bashkia Korçë, në katin e nëndheshëm të ndërtesës së ish-Konviktit, do të hapet një menzë për këta banorë, por edhe për persona të tjerë në nevojë, ku do t'i ofrohet ushqim falas.

Pavarësisht masave të sipërcituara, Bashkia Korçë, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, asnjë provë apo informacion, lidhur me masat që do të ndërmerren në të ardhmen për përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve të ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Referuar dispozitave të Kontratës së Huapërdorimit të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Korçë dhe banorëve të ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, evidentohet se pronësinë mbi këto ambiente e ka Bashkia Korçë. Në pikën 5 të nenit 4 të Kontratës së Huamarrjes, citohet se: *“Huamarrësi është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjen e zakonshme të objektit të dhënë në huapërdorje.”*

Nenet 3, 9, 23 dhe 24 të ligjit Nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, në mënyrë të përmbledhur parashikojnë se vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron zgjidhjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, si dhe realizimit të shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara në ligj ose akte të tjera normative, nëpërmjet mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane, si dhe përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin e banesave për strehim social, etj.

Edhe pse huamarrësit kanë detyrime mbi pronën në përdorim, riparimi i dëmeve të ardhura si pasojë e lagështirës së krijuar dhe higjenizimi i ambienteve të godinës, është detyrim i Bashkisë Korçë.

Në këtë kuadër, referuar informacionit të administruar, Bashkia Korçë nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë për përmirësimin apo sigurimin e kushteve normale të jetesës dhe gjetjen e një zgjidhje, për stehimin në kushte sa më dinjitoze të banorëve të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Në analizë të fakteve dhe provave të sipërcituara, kushtet e higjeno-sanitare, janë fakte të njohura dhe të konstatuara nga institucione të ndryshme, për të cilat Bashkia Korçë nuk ka marrë asnjë masë për t'i dhënë zgjidhje të qëndrueshme kësaj situatë. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Korçë, vendos në pozita të pafavorshme banorët e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Mbështetur në parashikimet e Nenit 19, të Ligjit Nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”, funksionet kryesore të strukturave rajonale të shëndetit publik janë:

- a) mbledhja dhe përpunimi i informacionit shëndetësor;
- b) analiza e gjendjes shëndetësore të popullatës dhe të faktorëve të riskut;
- c) analiza dhe ndërhyrja për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të shëndetit publik në kujdesin shëndetësor parësor;
- ç) edukimi shëndetësor dhe promovimi i shëndetit;
- d) kontrolli dhe parandalimi i sëmundjeve nëpërmjet programeve specifike të shëndetit publik;
- dh) ruajtja e shëndetit nga ndikimet e mjedisit, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe agjencitë rajonale të veçanta;
- e) informimi i popullatës.

Referuar informacionit të sipërcituar, ku parashikohet se Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë për përmirësimin e situatës së paraqitur nga banorët e ish-Konviktit të shkollës Bujqësore Korçë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka vijuar shqyrtimin e çështjes vetëm kundër subjektit Bashkia Korçë.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin⁷ 2 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet

⁷ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesit pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Bashkisë Korçë për shkak të *racës, ngjyrës, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore dhe shëndetësore*, shkaqe të cilat janë të parashikuara në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë trajtimit të ankesës, u administruan prova se ankuesit i përkasin komunitetit rom/egjiptian. Sa i përket shkaqeve të tjera të pretenduara, ankuesit nuk vunë në dispozicion asnjë provë apo argument.

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës, paraqiten në Nenin 2(2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20. Sipas Komitetit, statuset e “origjinës sociale”, “lindjes” dhe “pronës” janë të lidhura. Origjina sociale “*tregon statusin social të trashëguar të individit*”. Mund të lidhet me pozitën që kanë përfituar me lindjen në një komunitet ose klasë shoqërore të caktuar (si p.sh. përkatësia etnike, besimi fetar, ose ideologjia), ose nga situata shoqërore si p.sh. varfëria ose të qenurit i pastrehë. Shkaku i pronës mund të lidhet me statusin e dikujt në lidhje me tokën (si të qenit një qiramarrës, pronar ose banues i paligjshëm), ose në lidhje me pronën e të tjerëve.⁸

Referuar më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi e shqyrtoi ankesën mbështetur në shkaqet e argumentuara nga ankuesit, pra lidhur me racën dhe gjendjen e tyre sociale.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesit është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Korçë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁹, për të cilin ankuesit pretendojnë diskriminim dhe trajtimit të pafavorshëm të tyre.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, KMD vlerëson pozitive nismën e ndërmarrë për miratimin në buxhet për banesat sociale, por gjithsesi mbetet ende e pamiruar dhe do të kërkojë kohë për tu realizimin e saj. Rezultoi se Bashkia Korçë, nuk

⁸ Marrë në https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_ENG.pdf

⁹ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion lidhur me projekte apo plane, mbi masat aktuale që ka marrë ose që do të ndërmerret për përmirësimin apo sigurimin e kushteve normale të jetesës, për stehimin në kushte sa më dinjitoze të banorëve të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Komisioneri vlerëson se nga ana e palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesve se mosmarrja e masave për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, nuk ka ardhur si pasojë e racës apo gjendjes së tyre sociale.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Korçë. Pra, në këtë rast Bashkia Korçë, duhet të provonte se subjektet ankuese nuk janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Gëzimi i të drejtave të njeriut në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së¹⁰ sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike,

¹⁰ Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar.

sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gëzohen de facto, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Në proceset e aderimit në institucionet ndërkombëtare, Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë *“në gëzimin e të drejtave dhe lirive”* të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹¹

Shkaqet e origjinës sociale, lindjes dhe pronës paraqiten gjithashtu në Nenin 2(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1966. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e traktatit e ka zgjeruar kuptimin e tyre në Komentin e tij të Përgjithshëm 20. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore¹², për shtetet palë parashikon detyrimin për të njohur të drejtën e secilit për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tij.

Ligji Nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

¹¹ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_iaw_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

¹² Aderuar me ligjin nr. 7511/1991 *“Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”*

Nenet 3, 9, 23 dhe 24 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në mënyrë të përmbledhur parashikojnë se vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, si dhe realizimit të shërbimeve në përputhje me standardet e kërkuara në ligj ose akte të tjera normative, nëpërmjet mirëmbajtjes së rrugëve vendore, mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane, si dhe përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm, krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin e banesave për strehim social, etj.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në një sërë çështjesh ka mbrojtur të drejtën për strehim të kategorive vulnerabël, sidomos përkatësisë rome. Në çështjen *Moldovan dhe të tjerë kundër Rumanisë*¹³, Gjykata konstatoi shkelje serioze të një natyre të vazhdueshme të nenit 8 të Konventës. Gjykata arriti në konkluzionin se “...ishte e qartë nga provat e paraqitura nga ankuesit dhe nga vendimi i gjykatës civile që autoritetet policore ishin përfshirë në djegien e shtëpive të komunitetit rom. Duke qënë të detyruar të largoheshin nga fshati dhe shtëpitë e tyre, aplikantët ishin të detyruar të jetonin dhe ende sot disa vazhdojnë të jetojnë, në kushte skandaloze dhe të papërshtatshme, duke lëvizur vazhdimisht në vende të ndryshme, në kushte jashtëzakonisht të mbipopulluara. Nisur nga pasojat e drejtëpërdrejta të veprimeve të autoriteteve policore mbi të drejtat e ankuesve, Gjykata vlerësoi se autoritetet ishin përgjegjëse në lidhje me kushtet e mëvonshme të jetesës së aplikantëve. Nuk kishte asnjë dyshim se çështja e kushteve të jetesës së aplikantëve ra brenda fushës së të drejtës së tyre për respektimin e jetës familjare dhe private, si dhe të shtëpive të tyre. Prandaj, nenin 8¹⁴ i ishte qartësisht i aplikueshëm në këto rrethana”.

Përsa më lart dhe referuar frymës së përcjellë në rastet e gjykuara nga GJEDNJ, pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Korçë janë marrë masat për strehimin e banorëve të zhvendosur si rezultat i ndërtimeve urbanistike, Komisioneri vëren se duhet të kishte marrë masat për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës për këta banorë, si dhe të kujdesej në vijimësi për godinën, në mënyrë që të eliminoheshin pasojat e ardhura nga mbipopullimi i godinës së ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të një ankese¹⁵ tjetër të bërë nga banorët e ish Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, lidhur me kushtet e jetesës së këtë

¹³ Çështja *Moldovan dhe të tjerë kundër Rumanisë*, vendimi i 12 Korrikut 2005

¹⁴ I Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut: ku parashikohet se: “1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

¹⁵ Ankesa Nr. 110, datë 08.08.2017

godinë, në vendimin Nr. 42, datë 07.02.2018, të dhënë në përfundim të procedurës hetimore, ka rekomanduar në pikën 2 të tij: *“Me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, rekomandojmë Bashkinë Korçë, për marrjen e masave për mirëmbajtjen e godinës së ish-Konviktit të Bujqësore Korçë, deri në momentin që për banorët e vendosur në të, të gjendet zgjidhja përfundimtare e strehimit”*.

Nga ana e Bashkisë Korçë nuk u soll asnjë përgjigje apo masë e marrë lidhur mirëmbajtjen e godinës apo ndërhyrjen për përmirësimin e kushteve të jetesës në këtë godinë, në mënyrë që të parandaloheshin situata të cilat mund të sillnin rrezik në jetën e banorëve apo në shëndetin e tyre (megjithëse iu kërkua nga Komisioneri). Referuar barrës së proves sikurse është cituar dhe më lart në vendim, Bashkia Korçë duhet të provonte se subjektet ankuese nuk janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme, për shkak të racës apo gjendjes së tyre sociale, në raport me të drejtën për një standard të përshtatshëm të jetesës për vete dhe për familjen e tyre.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti që siguron mbrojtje efektive të nenit 18 të Kushtetutës të RSH-së ku parashikohet parimi i barazisë sipas të cilit të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm për të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.

Në përfundim të arsyetimit të sipërcituar dhe bazuar në informacionin e administruar nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatohet se me anë të mosveprimeve, Bashkia Korçë ka sjellë trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë të banorëve të ish konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë për shkak të racës dhe gjendjes së tyre sociale.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjekteve ankues, K. G., K. M., M. G. dhe E. Ll., për shkak të racës dhe gjendjes së tyre sociale, nga ana e Bashkisë Korçë.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Korçë, për përmirësimin e kushteve të jetesës në godinën e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, duke bërë higjienizimin e menjëhershëm të godinës, sistemimin e

tubacioneve të ujërave, eliminimin e lagështirës në këto ambiente, si dhe sistemimin e kabujve elektrik në korridoret e godinës.

3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Korçë, për sigurimin e ujit të pijshëm, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e marrja dijani për këtë vendim.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Korçë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca dhe gjendja sociale)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)